



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", e në mbështetje të nenit 28 paragrafi 2 pika (l) lidhur me nenin 29 paragrafi 2 pika (d), të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, e në zbatim të kërkesës së Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr. 020-122/3 të datës 19.03.2025, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2025, miratoi këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-12093

Neni 1

Me këtë vendim shfuqizohet vendimi, 01-Nr-016-12093, i datës 28.02.2025, më të cilin është dhënë pëlqimi për të zhvilluar procedurat e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër deri në pesë (5) vite të pronës së paluajtshme të komunës, për vendosjen e përkohshme të "Tabelave dhe panove reklamuese".

Neni 2

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024" dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-17945
Me datë 28-03-2025



Kryesuesi i Kuvendit
Mr.ec Bexhet KUÇI